

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “TEMPLE LOUNGE” SH.P.K.

Kavaje, me 14.09.2024

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 14.09.2024 harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon:

Ortakët themelues:

Shoqëria **B.T EDIL GROUP** me seli ne Rrogozhine, regjistruar prane qendres kombetare te biznesit me NIPT M42510802L, perfaqesuar nga administratori i saj Z. Fatos Memolla.

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin “TEMPLE LOUNGE” SH.P.K.

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare “TEMPLE LOUNGE” SH.P.K. ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.


NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “TEMPLE LOUNGE” SH.P.K. do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Tirane, rruga Naim Frasheri, ndertesa 60/3, nr. apartamenti 2, zona kadastrale 8210, nr. pasurie 4/138+1-2.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë



4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj si: bar-restorant, aktivitete të shërbimit të pijeve dhe aktivitete të fushës së gastronomisë. Tabachino dhe tregtimi i artikujve të ngjashëm

NENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “TEMPLE LOUNGE” do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare “TEMPLE LOUNGE” SH.P.K. mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë “TEMPLE LOUNGE” SH.P.K. dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “TEMPLE LOUNGE” SH.P.K. është 100.000 (njqind mije) lekë.

Ortake e shoqërisë është:

1. Shoqëria **B.T EDIL GROUP** zotërues i 1 (një) kuote në vlerë 100.000 leke, e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.



NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (Pese) vjet. Kompetencat e administratorit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë "TEMPLE LOUNGE" është Z. **Flavio Daja** lindur dhe banues ne Rrogozhine, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i ID me nr. personal J20225063B.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT

E SHOQERISË ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR

"TEMPLE LOUNGE" SH.P.K.

B.T EDIL GROUP

perfaqesuar nga administratori **Fatos Memolla**

